



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 324, datë 14.07.2022

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR MIRATIM TË
TARIFAVE TË SHITJES SË UJIT ME SHUMICË TË SHOQËRISË UJËSJELLËS
KANALIZIME DURRËS

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021 "*Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime*".

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 14.07.2022 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh. a për miratimin e tarifave të shitjes së ujit me shumicë të shërbimit të furnizimit me ujë,

Konstatoi se:

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Durrës është licencuar me vendimin e KKRR nr. 344 datë 23.09.2021 "*Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a*" për shkak të rinovimit të licencës pas përfundimit afatit.

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Durrës ka aplikuar pranë ERRU me shkresën nr. 3938 prot, datë 30.06.2022 me lëndë "*Kërkesë për nivel tarifor për shitje të ujit me shumicë për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm*".

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Durrës është plotësuar sipas Metodologjisë së Vendorsjes së tarifave, *përveç shlyerjes së detyrimit vjetor për pagesën rregullatore*.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Durrës është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në Vendimin nr. 539 datë 30.12.2021 dhe kuadrin rregullator në fuqi.

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Durrës për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.
2. Drejtoria Teknike Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Durrës dhe Bashkinë Durrës për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ndriçim Shani